



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Punimjen / Pradato Received / Delivered	03-02-2023	3	viti god year
Organ / Hjestra Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMBICK	1367/2023		115



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1190/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arditë Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Arditë Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1190/2022 të datës 15.12.2022 të parashtruar nga ankuesi

kundër Vendimit me numër KD.Nr.044/2022 të datës 16.11.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike "masë disiplinore" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 03.02.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1190/2022 e datës 15.12.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër KD.Nr.044/2022 i datës 16.11.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

A r s y e t i m

Inspektorja e Inspektoratit pranë Ministrisë së Drejtësisë përmes emailit të datës 21.10.2022 ka njoftuar se me datën 19.10.2022 në trajnimin e mbajtur nga Eulex në Hotel Emerald, gjatë kohës së daljes në drekë nga salla e trajnimit ka ndodhur një incident aspak i hijshëm... ku zyrtarit nga momenti i ngritjes së tij nga karriga arma i bie në tokë, ndërsa



përmes emailit të datës 21.10.2022 nga Zëvendësuesi i Kryeinspektorit të Ministrisë së Drejtësisë është rekomanduar që të fillohet marrja e masave disiplinore ndaj ankuesit.

Ndaj ankuesit i punësuar sipas Akt Emërimit AE.Nr.070/2022 të datës 26.08.2022 në pozitën Zëvendës Drejtor në Qendrën Korrektuese në Smrekonicë në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës, me datën 25.10.2022 është parashtruar kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore pranë Komisionit Disiplinor për shkelje të rënda të dispozitave ligjore.

Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës me datën 16.11.2022 ka nxjerrë Vendim KD.Nr.044/2022, me të cilin ka bërë përgjegjës ankuesin për shkelje të rënda disiplinore për shkak të ekspozimit të armës zyrtare dhe rënjes së saj në dysheme, duke i shqiptuar masën disiplinore *"ndalim 20% i pagës për periudhë një muaj"*.

Ankuesi kundër Vendimit KD.Nr.044/2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, më datë 15.12.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 8087/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 22.12.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Shërbimi Korrektues të Kosovës. Ndërsa Këshilli me datë 10.01.2023 ka pranuar nga Shërbimi Korrektues të Kosovës përgjigjen në kërkesë së bashku me shkresat e bashkangjitura.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e vendosjes nw lidhje me kwtw ankesë, ka administruar këto prova:* Ankesën me numër protokollit 8087/2022 të datës 15.12.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër KD.Nr.044/2022 të datës 16.11.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Flete kthesën e datës 21.12.2022; Procesverbalin e datës 15.11.2022 dhe 09.11.2022 të Komisionit Disiplinor; Kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit e datës 25.10.2022; Deklaratën më shkrim të ankuesit e datës 24.10.2022; Emailin e datës 21.10.2022 nga I.D për Xh.M; Emailin e datës 21.10.2022 nga M.B për I.D; Emailin e datës 21.10.2022 nga Z.S për M.B; Ftesë për intervistë e datës 04.11.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 22.12.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 10.01.2023; Akt Emërimit AE.Nr.070/2022 të datës 26.08.2022; Konkursin me Nr. Reference: RN00008825 për Zëvendës drejtor të Qendrës Korrektuese në Smrekonicë.

Me datën 27.01.2022, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin VK/2023 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankuesit edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga ankuesi, është e *pabazuar, sepse:*



Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër KD.Nr.044/2022 të datës 16.11.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, pretendon se komisioni disiplinor nuk ka trajtuar në mënyrë të drejtë procedurën disiplinore sepse nuk janë marr për bazë elementet e përgjegjësisë disiplinore, sepse në këtë rast nuk ka ndodhur asnjë pasojë këtë e kam thënë edhe në deklaratën e datës 24.10.2022.

Lidhur me përgjegjësin disiplinore, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, i'u referua nenit 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: "Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit". Ndërlidhur me këtë në kuptim të nenit 46 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, janë kualifikuar shkeljet e rënda të detyrave të punës: "Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mos përmbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrë; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i dehur në punë".

Nenin 47 paragrafi 1 më të cilin është përcaktuar se: "Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil".

Nenin 48 i cili ka përcaktuar se: "1. Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. 3. Masat disiplinore të parashikuara në paragrafin 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji, janë në kompetencën e komisionit disiplinor".

Bazuar në provat e lëndës, respektivisht bazuar në emailin e datës 21.10.2022 të Inspektorese së Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë, bazuar në deklaratën e ankuesit të datës 22.10.2022 dhe deklaratës pranë Komisionit Disiplinor të datës 09.11.2022, Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesit në trajnimin e mbajtur nga Eulex në Hotel Emerald, arma zyrtare i ka rënë nga brezi dhe ka qenë e ekspozuar ku në këtë trajnim ka pasur edhe persona të tjerë, ndërsa sipas Rregullit të Brendshëm për Pajisjen dhe përdorimin e Armëve të Zjarrit të datës 21.09.2020, në nenin 7 paragrafi 3 përcakton se: "Personeli i SHKK-së kanë të drejtë ta bartin armën e zjarrit edhe jashtë detyrës zyrtare, duke u kujdesur që



*arma të mos ekspozohet", rrjedhimisht ankuesit nuk i është ndaluar të bart armën e tij zyrtare, por i njëjti ka qenë i obliguar që të kujdeset maksimalisht që ajo mos të ekspozohet, ndërsa në rastin konkret përveç që është ekspozuar e njëjta i ka rënë në dysheme në momentin që ankuesit ka lëvizur nga vendi ku ka qenë ulur, me këtë rast Kolegji i Këshillit, vlerëson se ankuesi ka shkelur nenin e lartcekur të Rregullit të Brendshëm për Pajisjen dhe përdorimin e Armëve të Zjarrit të datës 21.09.2020, ngase ankuesi do të duhej të ishte shumë i kujdesshëm që arma mos të ekspozohet në publik për faktin që në trajnim ka pasur edhe persona të tjerë, si rrjedhojë ankuesi me veprimet e tij përveç që ka shkelje dispozitat e lartcekura, i njëjti me veprimet e tij ka vepruar në kundërshtim me nenin 28 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: **"Zyrtari publik gjatë punës së tij duhet të jetë i përgjegjshëm dhe gjatë ushtrimit të detyrës mban përgjegjësi të plotë sipas ligjit, për çdo veprim apo mosveprim të tij"**, sepse ankuesi ka bërë shkelje të rënd disiplinore të përcaktuar me nenin 46 paragrafin 3 nën paragrafit 3.10 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 58 paragrafi 3 nën paragrafi 3.4 të Ligjit Nr. 08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës.*

Andaj Kolegji i Këshillit lidhur me ligjshmërinë e Vendimit me numër KD.Nr.044/2022 të datës 16.11.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, konstaton se Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës, më rastin e nxjerrjes së këtij vendimi, ka vepruar në pajtim me nenin 45, 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, nenin 48 paragrafi 3, nenin 50 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitat të nenit 11, 12, 13 paragrafi 3, 4 dhe 5 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, ndërsa arsyetimi i vendimit është në pajtim me nenin 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si rrjedhojë Kolegji, konstaton se pretendimet e ankuesit ndaj kësaj mase janë të pabazuara.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 132 paragrafit 2 të Ligjit Nr.05/L-031 Për procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda, A.nr.1190/2022, datë 03.02.2022.

Ardita Perçuku-SHYTI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.